

REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE MINISTRY OF INFRASTRUCTURE	
Nivënia Org. Org. Jeshmëria Org. Unit Nr / Faqëve Br. Stranica No. Pages	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No. Datum Date
KM-MIT-01 2 PRISHTINË/A	313/19 13.05.19



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS MINISTARSTVO INFRASTRUKTURE MINISTRY OF INFRASTRUCTURE	
Nivënia Org. Org. Jeshmëria Org. Unit Nr / Faqëve Br. Stranica No. Pages	Nr. i Prot. Broj Prot. Prot. No. Datum Date
01 2	4973 13.05.19

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit
 Ministarstvo Infrastrukture i Transporta
 Ministry of Infrastructure and Transport

Ministri i Ministrisë së Infrastrukturës dhe Transportit , në mbështetje të nenit 145 (paragrafi 2) , të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 17 (paragrafi 5 dhe paragrafi 6) dhe nenin 38 (paragrafi 3) të Rregullores nr. 02/2011 për fushat e përgjegjesisë administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive (22.03.2011), Rregulloren Nr.26/2018 për ndryshimin dhe plotësimin e rregullores Nr. 02/2011 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 131 të Ligjit nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, nenin 5 dhe 21 të Ligjit nr.04/L-179 për Transportin Rrugor, nenin 7 të Udhëzimit Administrativ 09/2013 për rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus dhe rekomandimit të komisionit profesional, nxjerr këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa nr.1898 datë 26.02.2019 parashtruar nga grupi i operatorëve të transportit rrugor të udhëtarëve ("Memi Reisen"; "Zekaj Tours" ; "Balli Trans"; "Vëllezërit Ferizi"; "Lindi Tours -B"; " Geci Trans" ; "Gëzimi Kom" ; " Kujtimi Tours" ; "Vëllezërit Thaçi" dhe "Albi Tours") dhe ankesa nr. 2117 datë 04.03.2019 parashtruar nga operatori i transportit rrugor të udhëtarëve me autobus "Ismail Ahmeti B.I." kundër vendimit nr.1643 të datës 21.02.2019 mbi shpalljen e nisjeve të lira ndër-urbane nëpër regjione respektivisht nisjeve në relacionin Istog - Skenderaj(transit) Drenas (transit) - Prishtinë dhe ansjelltas (me orarë: 06:30 - 10:30 ; 16:10 - 19:10).

ARSYETIM

Komisioni i emëruar nga Ministri sipas vendimit nr.2259 datë 06.03.2019 pas shqyrtimit të ankesave, verifikimit të dokumentacionit dhe shkresave të tjera të lëndës dhe duke u bazuar në legjislacionin në fuqi respektivisht nenet 5 (paragrafi 4) dhe 7 të Udhëzimit Administrativ nr. 09/2013 mbi rrjetin e linjave dhe rendin e udhëtimit të transportit ndërrurban të udhëtarëve me autobus, poashtu duke pasë parasyshë rrjetin aktual të linjave ndër-urbane , konstaton se nisjet e shpallura në relacionin Istog - Skenderaj(transit) Drenas (transit) - Prishtinë dhe ansjelltas (me orarë: 06:30 - 10:30 ; 16:10 - 19:10) nuk pengojnë në nisjet e vërtetuara nga MIT-ja në

relacionin Skenderaj - Drenas - Prishtinë; Drenas - Prishtinë; Skenderaj - Drenas dhe anasjelltas nuk pengojnë në nisjet e vërtetuara pasi që nisjet e shpallura përbëjnë një relacion të ri dhe gjithashtu këto nisje përshkojnë transit territorin e Skenderajt dhe Drenasit pa të drejten e dnaljes gjegjësisht marrjes dhe zbritjes së udhëtarëve gjatë operimit dhe rrjedhimisht nuk pengojnë në nisjet ekzistuese të vërtetuara nga MIT-ja ne relacionet respektive.

Andaj duke pasë parasysh të cekurat më lartë dhe duke ju referuar legjislacionit në fuqi Ministria e Infrastrukturës dhe Transportit ka vlerësuar të domosdoshme shtimin e numrit të nisjeve të reja në mënyrë që të kemi shërbime të mjaftueshme për udhëtarët që frekuentojnë në këtë relacion duke krijuar një treg liberal me qëllim të ngritjes së cilësisë së shërbimeve dhe krijimin e mundësisve më të mëdha për qasje më të shpejtë dhe më lehtë në kryeqytet për qytetarët që shfrytëzojnë shërbimet e transportit me autobus.

Andaj në bazë të kësaj që u tha më lartë vendimi është marrë si në dispozitiv.

Këshilla Juridike:

Kundër këtij Vendimi pala e pa kënaqur mund të parashtrorjë padi në Gjykatën kompetente në afat prej 30 ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

I dërgohet:

- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Parashtruesit të ankesës;
- Departamentit të Transportit Tokësor;
- Arkivit të MI -së

